



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

### Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 27 qershor 2022

### Takimi filloi në orën 10.10

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës. Në takim ishte i pranishëm një numër i konsideruar i qytetarëve (32 pjesëmarrës); Nënkryetarja e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

### Tema:

**Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022, projektet dhe aktivitetet që janë në proces, si dhe ato të planifikuara për realizim**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, qytetarë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë takim, në bashkëbisedim që lidhet me raportin tonë gjashtëmuor të punëve dhe detyrave të cilat na tangojnë si Ekzekutiv i kësaj Komune. Sigurisht që do të isha i kënaqur që numri i qytetarëve të ishte shumë i madh në këtë diskutim publik për arsye se po flasim për projektet që cilat drejtpërsëdrejti e tangojnë jetën e qytetarëve. Ftesa ka qenë publike sipas afatit ligjor, në mënyrë që qytetarët tanë të jenë të informuar për këtë takim publik. Sidoqoftë do të bëjmë përpjekje që në pika të shkurtra t'i prezantojmë punët kryesore të kryera brenda kësaj periudhe kohore, dhe sigurisht pastaj do t'u jepet fjala, në mënyrë që të dëgjojmë kërkesat, nevojat, ato të cilat janë të rëndësishme, të cilat për çfarëdo arsye ne nuk kemi arritur me i realizuar gjatë kësaj periudhe kohore, ose kërkesat e reja të cilat janë të nevojshme që t'i fusim në agjendën tonë të punës. Atëherë të fillojmë sipas Drejtorive;

### Drejtoria e Administratës

-Marrja e shërbimeve/dokumenteve (certifikata e lindjes, ekstrakti i lindjes, certifikata e martesës, certifikata e vdekjes) online në portalin E-Kosova; që tashmë përmes Nivelit qendror por edhe te ne si Komunë është krijuar mundësia që të merren online përmes portalit eKosova i cili projekt sigurisht që ka relativizuar shumë punën e qytetarëve, të cilët fare pa ardhur këtu mund të pajisen me këto dokumentacione dhe shërbimet e tyre të nevojshme;

-Lëshimi i shërbimeve/dokumenteve në fletë të bardhë (për përdorim brenda vendi) në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr.01/2022 për Dokumentet e Gjendjes Civile;

-Mirëmbajtja dhe furnizimi i Zyrave të Gjendjes Civile nëpër fshatra (zyrat e vendit) me materiale dhe gjëra të tjera të nevojshme me qëllim të funksionimit sa më të mirë, në mënyrë që këto t'i kryejnë shërbimet e tyre;

-Vazhdimi i orarit fleksibil për qytetarët (marrja e shërbimeve edhe gjatë orarit të pauzës). Për një gjë tillë jemi në kontakt edhe me MPB-në që edhe Zyra e Regjistrimit Civil që edhe kjo të aplikojë dhe të na përshtatet me këtë orar fleksibil, në mënyrë që edhe aty qytetarët të kenë mundësi për t'i kryer shërbimet pa ndërprerje gjatë orarit të punës;

-Është funksionalizuar sistemi të pritjes në radhë me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore;

### **Drejtoria e Buxhetit dhe Financave**

-Janë bartur mjetet nga te hyrat vetanake te cilat nuk janë te shpenzuara ne vitin 2021 në vlerë prej 1,032,341.89 euro dhe këto mjete buxhetore janë ne dispozicion për realizim te projekteve ( infrastrukturë, arsim, shëndetësi etj.);

-Është hartuar korniza afatmesme buxhetore për vitet 2023-2025, e cila është bërë konformë kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, për arsye se janë mbajtur diskutime publike në disa lokalitete brenda Komunës tonë, si në fshatrat Orllan, Lluzhan, Kërpimëh;

-Janë realizuar të hyra vetanake në vlerë afër 800 mijë euro;

-Është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve te auditorit - raporti i auditorit për vitin 2021 është raport pozitiv. Mund të ju them se pas gjatë viteve të punës së institucioneve lokale ky vit është me raport pozitiv nga auditimi, çka do të thotë se kemi realizuar parakushtet që këtë vit të përfitojmë nga grantet e caktuara konform punës dhe performancës së mirë të dhënë nga auditori që lidhet me shpenzimin e mjeteve buxhetore të Komunës sonë;

### **Drejtoria e Arsimit**

Në vazhdim të shumë punëve që i ka realizuar po i përmendi disa prej tyre:

-Nga janari i vitit 2022 ka filluar furnizimi me shujta për nxënësit e klasave 1-5;

-Janë furnizuar shkollat me inventar vlera e projektit 70,000 euro;

-Dy shkolla janë furnizuar me kabinete të tik-ut;

-6 shkolla janë furnizuar me makina për dysheme;

-Janë krijuar 6 kënde të lojërave për fëmijë;

-Ka filluar ndërtimi i sallës së sportit në shkollën “Enver Maloku” në Podujevë;

-Ka përfunduar renovimi i çerdhes së re publike në qytet së shpejti bëhet edhe inventarizimi, dhe besoj se nga muaji shtator çerdhen e dytë publike do ta kemi funksionale;

-Me qëllim të rritjes së sigurisë në shkolla është duke u realizuar projekti për furnizim dhe montimin e kamerave në 14 institucione shkollore. Sikurse jeni në dijeni nganjëherë objektet tona shkollore po ballafaqohen me keqberës të cilët po i thyejnë dhe po shkaktojnë telashe. Tash kemi në plan që të gjitha objektet tona shkollore të vihen në vëzhgimin e kamerave dhe njëkohësisht pak a shumë ta lirojnë barrën nga rojet të cilat kanë funksionuar më herët;

-Janë nënshkruar disa marrëveshje me kompanitë vendore për realizimin e punës praktike të nxënësve të shkollave të mesme;

-Është në fazën e realizimit të marrëveshjes “Ndikimi i inisë në mjedis yeni” të nënshkruar me caritasin zviceran;

-Ka filluar realizimi i projektit “furnizim me kabinete të shkencave natyrore” për 11 shkolla;

-Është nënshkruar marrëveshja me ministrinë e arsimit, caritasin zviceran për themelimin e qendrës së karrierës në shkollën e mesme profesionale “Fan S. Noli” në Podujevë;

-Në fazën e prokurimit janë këto projekte “Përmirësimi i infrastrukturës shkollore”; “Ndërtimin i shkollës në fshatin Obrançë”; “Ndërtimi i shkollës në fshatin Lluga”; “Ndërtimi i sallës së sportit në shkollën “Naim Frashëri” në Podujevë; “Krijimi i platformës digjitale për shkolla”; “Furnizim me inventar për çerdhen e re”; “Transporti i nxënësve”; “furnizim me materiale shkollore për shkolla”;

### **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Projektet kapitale:

- Punët përfundimtare në objektin e QMF në Lluzhan;

- Inagurimi dhe funksionalizimi i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Dumnicë Poshtme;

- Punimet në QMF Gllamnik;

- Janë duke u kryer punimet në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Dobërdol;



- Punimet janë përmbyllë në objektin e emergjencës te shkolla "Enver Maloku" dhe këtë objekt të emergjencës po planifikojmë që ta vejmë në funksion në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në mënyrë që këtë objekt ta japim në dispozicion për kryerjen e shërbimeve specialiste, për spitalin e "famshëm" që tash e sa vite e kemi në letra por që fatkeqësisht nuk e kemi realitet. Po shpresojmë që në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë së shpejti do ta funksionalizojmë, sepse objekti i ri ka kushte të përshtatshme dhe besoj se kemi me filluar me shërbime bazike specialiste gjatë kësaj periudhe kohore, objekti është i gatshëm, një pjesë e personelit mjekësor janë pranuar me kontratë që të punojnë në Podujevë dhe na nevojiten të bëjnë zgjedhjen për stafin e mesëm shëndetësor dhe mirëmbajtjen e këtij objekti dhe besoj që në këtë gjashtëmujorin e dytë duhet me fillua për herë të parë për qytetarët tanë që shërbimet specialiste të kryhen në Komunën e Podujevës;
- Punimet parapërgatitore për objektin e emergjencës së re te ish hotel Besiana;
- Janë përfunduar punët në objektin e QKMF-Podujevë;
- Furnizimi me pajisje medicinale dhe barna të nevojshme për QKMF- Podujevë, ku mund të ju them lirisht se ndoshta këto vitet që jemi duke qeverisë është prej furnizimeve më të mirë me barna të cilat janë duke i ndihmuar shumë qytetarëve tanë. Sikurse jeni në dijeni, nuk është një kohë e largët kur qytetarët tanë kanë qenë të detyruar që ndoshta edhe gjilpërat, prej atyre më të thjeshtat ti blejnë për t'i kryer shërbimet e veta qoftë në QKMF, qoftë në QMF në terren dhe fatmirësisht kemi një furnizim jashtëzakonisht të mirë dhe ndoshta për herë të parë shumica e barërave të nevojshme qytetarët kanë mundësi ti marrin, si në QKMF qoftë në QMF që janë në terren;
- Rritja e fondeve 70% si mbështetje financiare për pacientë me sëmundje kronike për përfituesit individual 80,000.00 € dhe për OJQ-të 20,000.00 €;
- Në bashkëpunim me shoqatën "Jetimat e Ballkanit" për 13 familje është duke u realizuar ndërtimi i shtëpive të tyre dhe jemi në pritje për fillimin e ndërtimit të 7 shtëpive tjera;
- Po ashtu në bashkëpunim me Organizatën Shqiptarët për Shqiptarët, tashmë ka filluar realizimi i projektit të madh në vlerë mbi 1,200,000.00 € për ndërtimin e 24 deri 26 shtëpive të banimit në lokalitetin periferik të Komunës së Podujevës, në drejtim të rrugës për në fshatin Dumnicë dhe besojmë se me ndërtimin e këtij kapaciteti banues ne kemi për ta zbutur jashtëzakonisht shumë çështjen e banimit për qytetarët në nevojë të banimit;
- Kemi mbështetur me 20,000.00 euro OJQ-të që merren më çështje sociale apo persona me nevoja të veçanta, në veçanti vlen ta përmendim mbështetjen financiare ashtu siç e kemi premtuar për fëmijët me autizëm. Kemi pas një premtim elektoral që do e mbështesim këtë kategori, dhe atë e kemi realizuar, ku fëmijët janë duke vijuar procesin e rregullt mësimor në shkollën fillore "Ibrahim Rugova";
- Përmes subvencioneve me mjete financiare janë ndihmuar 442 familje në shumë prej 53,550.00 €, pra janë familje që kanë probleme të ndryshme shëndetësore;

### **Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

Ka kryer një varg punësh dhe detyrash në domenin e saj:

- Tashmë e kemi të miratuar Hartës Zonale, përmes së cilës faktikisht u vu një kornizë ligjore sa i përket aspektit të ndërtimit por edhe aspektit të zgjerimit urban;
- Kanë filluar punimet në rrugën "Skenderbeu" në gjatësi 2.4 km, ku kjo rrugë do të jetë e kompletuar me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, duke filluar me kanalizim, ujëra atmosferike, rrjetin e ujësjellësit, trotualet, ndriçimin publik dhe asfaltimin e tërësishëm të saj por edhe urat të cilat janë të nevojshme do të zgjerohen dhe do ta kem një infrastrukturë moderne në shtrirjen e kësaj rruge;
- Është lidhur kontrata për asfaltimin e disa rrugëve lidhëse Buricë-Konushec Llaush-Dobërdol Dumosh-Sfeqël dhe Kaqibeg-Sibofc në gjatësi 3.1km dhe e disa rrugëve në



- fshatrat; Tërnavë - Halabak - Lupç - Majac - Popovë - Dyz - Bellopojë në gjatësi 4 km;
- Është në procedurë të prokurimit projekti për asfaltimin e rrugës Kalaticë-Brainë-Bërvenik me gjatësi 3.7 km dhe rrugës në fshatin Turuqicë me gjatësi 4.1 km investim nga Ministria e Infrastrukturës;
  - Është në procedurë të prokurimit projekti për asfaltimin e disa rrugëve në fshatrat - Obranqë-Katunisht - Llapashticë - Lluga - Konushëfc - Orllan - Brain - Turuqicë - Herticë - Barainë – Gërdofc, Sfeqël Gllamnik në gjatësi prej 10.1km;
  - Është në procedurë të prokurimit projekti për rregullimin e hapësirave të reja publike në qytet dhe është në fazën e vlerësimit të ofertave shtimi i hapësirave të gjelbërta publike në qytetin e Podujevës;

#### **Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë**

- Totali i lëndëve të trajtuara nga Kadastrit dhe Gjeodezia për 6 muaj: 1326 lëndëve të ndryshme;
- Nga sektori i Pronës janë 6 aktvendime për lirim të pronës së uzurpuar. Gjatë tërë kësaj periudhe kohore, kjo Drejtori është marr me probleme të ndryshme të dala nga procesi i shpronësimit të pronave që lidhen me hapësirën e ndërtimit të parkut industrial në sipërfaqe prej 37.4 ha, pra ka probleme të mospërputhjes së gjendjes grafike me gjendjen reale të atyre sipërfaqeve në terren dhe një periudhë relativisht e madhe e punës dhe e angazhimit të kësaj Drejtorie në këtë segment;

#### **Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sport**

- Janë mbështetur financiarisht tri projekte teatrore për repertorin e teatrit të qytetit në vlerë 25,000 euro;
- Janë mbështetur financiarisht disa klube sportive 27,800 euro;
- Është në fazën finale ndërtimi i fushës së futbollit në Peran, i cili është projekt në ndihmë shkollave dhe klubeve futbollistike që garojnë në kategoritë e ulëta të futbollit;
- Është në përfundim galeria e arteve, e cila do të shërbej si hapësira e ekspozimit të krijimtarisë artistike dhe si hapësirë në të cilën do të mund të realizohen aktivitete të tjera kulturore, siç janë: Festivale letrare, Panaire dhe të tjera;
- Jemi në fazën përfundimtare të realizimit të projektit renovimi i bibliotekës, në hapësirat e objektit të vjetër të komunës, por që këtu kemi has në disa probleme ligjore të cilat jemi në përpjekje për ti tejkaluar për ta përmbyllur suksesshëm këtë projekt;
- Jemi në përgatitje të caktimit të lokacionit për ndërtimin e një pishine të mbyllur gjysmë olimpikë, në vlerë prej 1.5 milion euro;
- Kemi bërë një mbështetje financiare për projektet kulturore dhe rinore në vlerë 22000 euro, është në fazën finale të vlerësimit;
- Jemi në proces të nënshkrimit të marrëveshjes për ndërtimin e qendrës multifunksionale, projekt që kap vlerën afër 1 milion euro;
- Jemi në proces të përgatitjes dhe inicimit të procedurave për ndërtimin e disa mjeteve për fitnes të hapur, të cilat do të vendosen në parkun e qytetit;
- Kemi inicuar blerjen e titujve të ri të librave në vlerë 20,000 euro, me qëllim të furnizimit të bibliotekës së qytetit;
- Jemi në prag të fillimit të ndërtimit të fushës së tenisit në bashkëpunim me Manchesterin e cila do të bëhet në hapësirën e parkut të Manchesterit. Tashmë jemi futur në një kontratë të qira marrjes nga INFRAKOS, për një hapësirë të caktuar me qëllim të realizimit të këtij projekti dhe jemi duke bërë përpjekje që një projekt të ndërtimit të fushave sportive, e i cili ka qenë i vitit të kaluar dhe kompania e cila nuk ishte në nivel të detyrës, kemi qenë të obliguar që t'ia shkëpusim kontratën dhe tani jemi në prag të ri tenderimit për realizimin e projektit të cekur në disa lokalitete;



### **Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim**

Është një prej Drejtorive që ka një volum jashtëzakonisht të madh të punëve dhe detyrave të saja dhe është duke i realizuar ashtu sikurse janë planifikuar, dhe atë:

- Është punuar në mirëmbajtjen dimërore e rrugëve dhe trotuareve, që besoj se ken i pas shërbime më kualitative se herave tjera;
- Ka përfunduar zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në fshatrat - Gllamnik - Godishnjak - Sibofc - Penuhë - Katunisht - Sfeçël – Bellopojë;
- Kemi mbjell mbi 1600 drunjë dekorativ kryesisht për rrethe rrugëve kryesore dhe në brigjet e lumit llap si dhe janë mbjell mbi 10,000 lule te llojeve te ndryshme ne qytet dhe pjesën periferike të tij;
- Është vazhduar puna në ndërtimin e trotuareve në qytet dhe fshatra - Letanc - Pakashticë e poshtme - Llapashticë e poshtme - Sfeçël - Lupq i poshtem - Bellopojë - Gërdoc;
- Është duke u punuar në projektet për mirëmbajtje si: Mirëmbajtjen e trotuareve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e pastrimit të lumenjve - riparimi i rrugëve të asfaltuara si dhe është riparuar shëtitortja pranë Lumit llap;
- Është duke u punuar në ndërtimin e 21 urave të reja në fshatrat - Pakashticë e epërme, Bajqinë, Dobërdol, Ternave, Sekiraq, Zhiti, Repë, Lupq, Dvorishtë, Batllavë, Surkish, Dumnicë, Lugë dhe Llapashticë e poshtme. Këtë vit mund ta quajm edhe vit të ndërtimit të urave;
- Është duke u punuar në projektin trajtimi i qenve endacak. Është një prej problemeve dhe sfidave relativisht të mëdha të trajtimit të këtyre qenve. Ne vitin e kaluar por edhe këtë vit kemi ndarë një shumë të mjeteve buxhetore për trajtimin e qenve endacak, por menaxhimi dhe mbikëqyrja e tyre është bukur problematike. Sado nganjëherë krijohet përshtypja se u larguan të gjithë, pas dy dite e kemi gjendjen e njëjtë, d.m.th. mobiliteti i tyre dhe mundësia për mobilitet qoftë me inicim qoftë pa inicim është relativisht i madh dhe është një çështje bukur problematike për me menaxhua dhe me mbikëqyrë. Sidoqoftë numri i tyre është shumë më i vogël se sa ishte kohë më parë, por nuk mund të themi se jemi tërësisht të mbyllur me realizimin e këtij projekti;
- Janë duke u zhvilluar punimet në projektin rregullimi i infrastrukturës rreth varrezave pakashtice e poshtme - Llaushe - do te vazhdohet edhe ne Gllamnik e Perpellac;
- Është duke u punuar ne kolektorin e ujërave atmosferike ne lagjen Toverlani dhe Shala. Ju e dini që këto lagje kanë qenë lagje të cilat në çdo rast të reshjeve të mëdha ato kanë qenë të vërshuara dhe të përmytura. Faktikisht jemi në fazën finale të zgjedhjes së këtij problemi dhe po besoj se me përmylljen e suksesshme të këtij projekti do të përfundojë dhe do të zgjidhet problemi i këtyre dy lagjeve;
- Është duke u punuar ne projektin largimi i deponive ilegale – janë larguar mbi 50 deponi ilegale, por edhe këtu kemi vështirësi të mëdha në menaxhimin e tyre. Një numër i ekonomive familjare ende nuk janë futur në sistemin e pagesave të mbeturinave, edhe përkundër faktit që kemi një pagesë shumë simbolike 4.70 €, që sikur të futeshin në sistem kjo do të na ndihmonte shumë në zgjidhjen e problemit të deponive ilegale. Nga këtu po u bëjë apel juve të pranishëm, por përmes juve edhe qytetarëve të Komunës së sonë, që të gjithë ata që nuk janë futur në procesin e pagesës për pastrim të mbeturinave i lus që të futen në këtë proces sepse do të na ndihmonin jashtëzakonisht shumë. Çdo vit jemi duke shpenzuar shuma të mëdha të mjeteve për largimin e këtyre deponive ilegale, por një pjesë e qytetarëve po i keqpërdorin dhe po i hedhin vend e pavend mbeturinat. Do të ishte mirë që ne kishim me pas gatishmërinë që me marrë ndoshta përgjegjësi për një pjesë të atyre ekonomive familjare që edhe mund të mos kenë kushte financiare për të paguar. Por besoj shumë që çdo ekonomi familjare ka mundësi një shumë të tillë ta përballojë;



- Është duke u punuar në projektin e “zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit” në Dumosh, Qytet në rrugën “Ibrahim Demolli”;
- Kanë përfunduar procedurat dhe pritjet të fillojë projekti „ndërtimi i rrugëve me elemente të betonit” do të punohen mbi 50 rrugica në qytet dhe fshatra;
- Ka filluar ndërtimi i shtegut të biçikletave në rrugën “Zahir Pajaziti”, tashmë kjo rrugë veç e ka një shteg të tillë, por nga këtu kam një lutje për ata që vozisin makina që të respektojnë këtë shteg të biçikletave, në mënyrë që biçiklistët ta kenë sigurinë e tyre, sepse është ndërtuar enkas për ta, prandaj shoferët duhet të ndërgjegjësohen dhe të kenë parasysh se në momentin që shkelet mbi këtë shteg është bërë shkelje e ligjit për komunikacion dhe ka mundësi reale që të gjobiten. Besoj se shtegu i dytë do të jetë i gatshëm posa të përfundoj projekti në ndërtimin e rrugës “Skënderbeu”, sepse edhe aty kemi planifikuar shtegun e biçikletave;

### **Drejtorja e Inspeksionit**

Ka kryer një varg punësh dhe detyrash që lidhen me këtë Drejtori, dhe atë:

- Ndalimi i ndërtimeve pa leje, në veçanti një punë relativisht e madhe është bërë në zonën e fshatit Orllan, ku kemi pas një fluks dhe një presion të madh dhe tendencë të madhe të ndërtimeve pa leje;
- Lirimi i hapësirave publike;
- Kontrolla inspektuese të vazhdueshme për mbrojtje të ambientit;
- Parandalimi dhe konfiskimi i prerjes së pyjeve;
- Gjobitje e shkelësve të ligjit;

### **Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Është prej Drejtorive që po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer një varg punësh dhe aktiviteteve, si në vijim:

- Thirrje publike për mbështetjen e 40 fermerëve me nga 1400 fidane të mjedrës, si dhe publikimi i listës së fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit;
- Thirrje publike për përkrahjen e 140 fermerëve me nga 5 shoqëri bletësh dhe nga një koshere tre katesh antivaro, si dhe publikimi i listës së përfituesve;
- Thirrje publike për mbështetjen e 108 fermerëve me Mëshqerra. Sot është duke u bërë shpërndarja e tyre dhe edhe fermerët ishin jashtëzakonisht të kënaqur me kualitetin e atyre mëshqerrave;
- Thirrje publike për mbështetjen e 50 familjeve në nevojë me Serra Bujqësore 96m<sup>2</sup>, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën Qatar Charity;
- Shitja e masës drusore të deponuar në depon e përkohshme të pylltarisë në fshatin Peran. Për herë të parë realizohet një projekt i tillë, i shesim ato dru me një çmim ndoshta më të mirë se sa kemi nevojë me i ble. Nga kjo shitje prej 350 m<sup>3</sup> kemi përfituar 22,000 € apo 60 € për 1 m<sup>3</sup>, që asnjëherë deri tani nuk ka ndodhë. Sepse e dini gjithmonë janë shitur formalisht, me çmim simbolik;
- Thirrje publike për mbështetjen e 152 fermerëve me Serra 50m<sup>2</sup>. Vlen të theksohet se për herë të parë kemi zgjatur afatin e aplikimit sipas thirrjes publike, sepse nuk është plotësuar numri i aplikantëve sa kemi mundësi me dhanë serra. Kjo do të thotë se ne duhet prej vitit të ardhshëm të shikojm mundësinë e ndërrimit të destinacionit të investimeve në bujqësi, për arsye se është hera e parë që kemi më pak aplikues për serra se sa kemi mundësi me u dhënë;
- Thirrje publike për mbështetjen e fermerëve me Mekanizëm Bujqësor (Motokultivator me frezë 90, shpërndarëse plehu 38, spërkatëse me kardan 20, kositëse bari 20, frezë dheu 20, mbledhëse bari luledielli 10, makina mjelëse 40, laktofriz 10- kjo është aplikuar për herë të parë dhe duke marrë përbazë kërkesat dhe nevojat për laktofriz për ruajtjen e qumështit);



- Përmbyllja e procesit të aplikimit të rreth 1850 fermerëve në kuadër të Programit për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2022 nga MBPZHR;

### **Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik**

- Ka përfunduar Analiza e Fizibilitetit për projektin e parkingut nëntokësor, është aprovuar nga komiteti për partneritet publiko-privat dhe do të fillojmë me procedura të tjera për zbatimin e këtij projekti. Fatmirësisht ky projekt ka ec, ka pas një progres shumë të mirë. Në Këshillin Ministror ky projekt ka kaluar dhe është aprovuar si projekt, dhe besoj se shumë shpejtë do të procedohet për realizimin e këtij projekti përmes formës së partneritetit publiko-privat;
- Kemi përfituar projekte në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal në thirrjen “Programi për Zhvillim Rajonal 2022 (Investimet Kapitale)”: Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve, faza e parë (I). Besojmë shumë shpejtë do të fillojë procesi i ndërtimit të objektit të Stacionit të Autobusëve. Objekti do të ndërtohet në afërsi të ish Motel Besianës;
- Kërkesa për vazhdimin e projektit të vitit 2021 - Ndërtimi i urave në fshatrat Sfeqël, Bajqinë dhe Gllamnik;
- Është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit me organizatën HELP për shpërndarjen e pajisjeve për punë të 22 përfituesve të ndarë në sektorë të ndryshëm si: Gastronomi, Rrobaqepësi, Dizajn dhe Prodhime tekstili;
- Memorandumi i Bashkëpunimit me BSCK për furnizimi me pajisje pune për 14 përfitues të ndarë në sektorë të ndryshëm si: Gastronomi, Autolarje, Zdrukthëtari, Rrobaqepësi, Parukeri etj;
- Funkcionalizimi i Tregut. Këtë ende nuk kemi arritur ta bëjmë. Po ka vështirësi për t’i tërheqë qytetarët atje, ndoshta edhe që në fillim nuk e ka pas vendin aty. Po shpresoj shumë se me tërheqjen e Stacionit të Autobusëve nga lokacioni aktual do ta funksionalizojmë tregun e ri atje dhe ndoshta ai treg kishte me qenë më atraktiv për ata që merren me këtë punë;
- Jemi në proces të kryerjes së tërë procedurave në bashkëpunim me AKP-në por edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës për Parkun Industrial, kemi hasur në vështirësi, kemi dashur shumë më shpejtë të ec procesi por kemi pasur probleme relativisht shumë me pronën, sa që na është dashur të gjitha ato parcela edhe njëherë t’i masim sepse nuk përputhet gjendja në terren me gjendjen grafike që e kemi këtu dhe kjo na ka shkaktuar pak një ngecje në kohë, por shpresojmë të ecim më shpejtë sepse kjo është një punë e kryer në kuptim të këtyre parcelave dhe po presim që Qeveria ta aprovojë procesin e shpronësimit dhe të vazhdojmë me procedurat tjera për ndërtimin e Zonës Industriale, s’paku infrastrukturën fizike ta mbarojmë këtë vit dhe vitin tjetër të ecim drejtë procesit të funksionalizimit të përgjithshëm të kësaj zone;
- Është iniciuar procedura për prokurim “Investime në infrastrukturën e turizmit”, jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës për mirëmbajtjen e Parkut të Paqes në qytet;
- Është iniciuar procedura për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës. Jemi duke parë që po hasim në vështirësi dhe po kemi shpenzime në shuma të mëdha qoftë në zgjerimin e hapësirës gjelbëruese, qoftë në mirëmbajtjen e kësaj hapësire, mirëmbajtjen e varrezave dhe shumë punë tjera, andaj po planifikojmë siç kemi premtuar që të krijojmë një ndërmarrje lokale komunale, ndërmarrje e cila do të merret me të gjitha këto punë. Në vend që të japim tenderë firmave dhe bizneseve të ndryshme, të krijojmë dhe financojmë ndërmarrjen tonë, të bëjmë punësimin e një numri të punëtorëve dhe ta kenë përgjegjësinë drejtpërsëdrejti në raport me ne, në mënyrë që punët të kryhen më mirë dhe të ketë një mbikëqyrje më të mirë;
- Deri tani është bërë hapja e 28 puseve për ujë që është donacion nga Chatar Charity dhe vazhdon si projekt të realizohet;



Këto janë disa prej punëve dhe projekteve të cilat janë realizua në këtë periudhë 6 mujore nga ajo që kemi paraparë si qeverisje lokale. Ajo që më gëzon fakti është Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit që është pozitiv këtë vit, që ka të bëjë me shpenzimin e parasë publike, na bën të shpresojmë që ne si Komunë të jemi përfitues i një granti nga Niveli qendror i cili mund të shkojë në shumën deri në gjysmë milioni apo më shumë, mjete të cilat kemi mundësi t'i shpenzojmë në realizimin e disa projekteve të cilat nuk kanë qenë të planifikuara për këtë vit. Shoh se në kuadër të këtij materiali nuk janë përfshirë një numër i madh i projekteve e që është dashur të jenë, të cilat janë duke u realizuar, fjala vjen te Drejtoria e Arsimit është shpallur konkursi për bursa për studentë që është 100% më i rritur se sa vitin e kaluar që është një projekt i cili do të realizohet shumë shpejtë, por kemi edhe një varg projektesh tjera, të cilat nuk janë përmendur këtu, siç është rasti këto ditë presimin nënshkrimin e marrëveshjes për fillimin e ndërtimit të objektit të urgjencës së qytetit të Podujevës, vlera e të cilit projekt është 1,600,000.00 € dhe është prej projekteve kapitale më të mëdha që do të realizohet, një projekt i cili do të na ndihmojë shumë në përmirësimin e kushteve më të mira për personelin shëndetësor, por edhe për shërbime më të mira për qytetarët tanë. Tashmë jeni të informuar që ky objekt do të ndërtohet në hapësirën në afërsi të ish hotelit të Besianës, te lokaliteti ku janë disa hekurishte, ku veç jemi në fazën e lirit të hapësirës, në mënyrë që të krijohen kushtet për fillimin e realizimit të këtij projekti. Ajo që nuk kemi informacione të mira e që duhet të jenë në dijeni qytetarët është fakti që ndërtimi i rrugës Prishtinë-Podujevë është duke shkuar me ritëm shumë të ngadalshëm dhe deri tash kemi realizuar një varg kontaktesh me Ministrinë, me Kryeministrin por edhe resorët përkatës në Ministri dhe na është premtuar se do të rritet intensiteti i punëve, por ju po e shihni që kompanitë e ndryshme kanë probleme të mëdha këtë vit për shkak të ndryshimeve të shpeshta të çmimeve dhe të jeni të bindur se në një numër të madh i Komunave me të cilat ku jam duke diskutuar janë duke u realizuar fare pak projekte. Nganjëherë po krijohet përshtypje se jemi një prej komunave që relativisht mirë është duke u punuar, përkundër këtyre vështirësive dhe problemeve të cilat kanë kompanitë e ndryshme. Fatmirësisht ne kemi pas një numër jo shumë të madh të atyre projekteve shumëvjeçare, se në veçanti ato janë problemet, për arsye se ata kur kanë marrë tenderët i kanë marrë me çmime shumë të ulëta, dhe tash kanë probleme shumë të mëdha për t'i realizuar për shkak të ngritjes enorme të çmimeve. Këtu na është premtuar nga ana e Niveli qendror se do të bëjnë çmos, tash edhe me rishikim të buxhetit do e rrisin shumën e mjeteve buxhetore për rrugën Prishtinë-Podujevë dhe presim që kjo rrugë të realizohet. Unë kam shprehë shqetësimin tim për mos realizimin e këtij projekti dhe sigurisht se edhe ata e kanë marrë me seriozitet këtë çështje.

Çështje tjetër që nuk ka ecur është Spitali, objekt i cili që sa vite prehet shirit pas shiriti, ndërsa puna nuk po realizohet. Neve na është thënë se është një kredi e cila ka mundësi të merret për atë Spital. Unë qëllimisht jam duke kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë që të fillojnë me shërbime specialistike në objektin e ri që është planifikuar për emergjencë në afërsi të shkollës "Enver Maloku" në mënyrë që qytetarët mos të presin dhe të kenë mundësi t'i kryejnë ato shërbime specialistike në Podujevë e jo të shkojnë në Prishtinë. Kam besimin se me Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë ku kemi realizuar dy takime, me Drejtorin e SHSKUK po ashtu ke pasur 2-3 takime dhe na është premtuar se në këtë gjashtë mujorin e dytë do të ndahen mjete shtesë për stafin e mesëm mjekësor dhe mirëmbajtjen në mënyrë që të kemi mundësi funksionalizimin e këtij shërbimi për qytetarët tanë. Në momentin që ne do të kishim arritur për të aktivizuar këtë shërbim dhe kemi mundësi që SHSKUK t'i japim në shfrytëzim atë objekt deri sa ta bëjmë objektin e ri, kjo na krijon neve një hapësirë të mjaftueshme kohore, për të menduar që lokacioni që është caktuar më herët nga të tjerët lidhur me ndërtimin e këtij Spitali a është adapt apo s'është. Ju të gjithë e dini që ajo hapësirë, përveç faktit që na kanë rrënuar një objekt që e kemi pas në dispozicion, nuk i plotëson as për së afërmi kushtet për spital aty, për arsye se në rend të parë nuk ka hapësirë të mjaftueshme parkingu, prandaj duhet menduar dhe analizuar mirë me zyrtarët përkatës që janë të profilit të



shohim se ku duhet të jetë destinacioni më i mirë për ndërtimin e Spitalit të qytetit të Podujevës. Unë e kam besimin e plotë që këtë gjë do ta bëjmë në bashkëpunim me qytetarët tanë, por edhe me ekspertë të fushës, por mendimi i ynë, por edhe i imi personalisht është që Spitali i qytetit duhet ndërtuar jashtë qytetit të Podujevës, prandaj i kemi disa lokalitete, që tashmë i kemi piketua dhe në një kohë optimale do ju bëhet e dijshme të gjithë qytetarëve se cili do të jetë vendimi për ndërtimin e këtij Spitali. Po ashtu shpresoj se do të gjendet formë dhe mënyrë edhe nëse nuk kanë mundësi të mjaftueshme financiare institucionet tona do gjejmë edhe donacione tjera të cilat do të na ndihmonin në realizimin e këtij projekti. Tjetër, që mendojmë se është e rëndësishme dhe jemi në diskutim me një numër investitorësh të ndryshëm janë edhe disa projekte kapitale, të cilat mendoj që sot nuk po i bëjmë publike sepse po presim t'i përafrojmë mendimet dhe idetë, por unë besoj që dy projekte tjera kapitale të Podujevës dhe llapit do t'i jepnin kahe të zhvillimit ekonomik të mirëfilltë dhe për këtë jemi në diskutime qoftë me donatorë të brendshëm, qoftë me ata të jashtëm që të gjejmë mirëkuptim për realizimin e tyre dhe besoj se me kohë qytetarët tanë do t'i informojmë për të gjitha këto punë.

Këto janë punët dhe aktivitetet të cilat janë kryer dhe juve sigurisht si qytetarë ju interesojnë se si është duke ecur procesi, por sigurisht ju mund të keni ndonjë nevojë apo kërkesë të reja të cilat do të jenë shumë të mirëseardhura për ne sepse çdo kërkesë të juajën kemi për obligim t'i japim kahje të zgjidhjes së atyre nevojave dhe problemeve me të cilat ju ballafaqoheni. Harrova të cek, se rruga në drejtim të Bellasicës është projekt që do të realizohet këtë vit, është një rrugë shumë e gjatë, më e gjatë se të gjitha rrugët tjera, por edhe një rrugë që shkon në drejtim të Zhegrovës që është po ashtu shumë e gjatë, do të realizohet brenda kësaj periudhe kohore. Faleminderit shumë dhe me dëshirën më të madhe pres sugjerimet e juaja, pse jo edhe vërejtjet të cilat janë domethënëse dhe mund të jenë të mirëseardhura për ne. Fjala është e juaja.

**z.Bedri Bashota nga fshati Llapashticë**, theksoi jam mërgimtar nga Norvegjia. Është hera e parë që jam në Komunë. Ju përsënderes të gjithëve. Mora fjalën vetëm të ju përgëzojë, të ju falënderojë për punën që jeni duke e bërë. Kur hyra në Komunë, dola jashtë njëherë të shikoj dhe thash se a jam në Norvegji apo në Podujevë dhe e lexova tekstin mbi derë dhe u binda se jam në Podujevë. Po ua them me sinqeritetin më të madh, këtë shërbim që e pash sot dhe këtë rregullsi edhe ne në Norvegji nuk e kemi, prandaj nuk do të ju marr kohë, por ju falënderoj nga zemra dhe si qytetarë i thjesht që jam shfrytëzoi rastin që të ju ftoj që të bëni ndonjë vizitë në Norvegji i nderuari Kryetar, jeni i mirëseardhur.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, faleminderit i respektuari mërgimtar. Besoni edhe mua po më bëhet qejfi që paske pas fatin që sot të jeni këtu dhe po ashtu ju dëshiroj që të keni pushime të këndshme këtu në Podujevë. Gjithashtu ju informoj me parkingun i cili do të jetë në dispozicion për ju për mërgimtarët. Nëse do të jetë nevojë këtë vit do ua rris kapacitetin e parkungut, e kemi edhe parkingun e vogël që e kemi përballë Komune. Do të ishte mirë që çdo sugjerim i juaji prej vendeve nga vini neve do të ndihmonte shumë me përvojat tuaja. Po bëjmë përpjekje që këto shërbime për nevojat tuaja t'i avancojmë. Në vazhden e avancimit të këtyre shërbimeve është edhe kërkesa që i kemi bërë MPB që Qendra e Regjistrimit Civil, shërbim i cili nuk është në domenin tonë si institucion lokal që të ketë orarin fleksibil të ngjashëm që e kemi bërë ne si Komunë, në mënyrë që të mos ketë shkëputje prej orës 12 deri në ora 13, por të kenë mundësi që shërbimet t'i kryejnë edhe gjatë kësaj kohe. Andaj më bëhet qejfi që përshtypjet tuaja janë të mira dhe shpresojmë që këto shërbime t'i avancojmë edhe në të ardhmen.

Ju lutem i mos hezitoni, folni, jo vetëm fjalë mira po na jepni edhe vërejtjet, sepse ato do të jenë të mirëseardhura për ne për lëshime apo në punë për t'i përmirësua.

**z.Nuradin Hyseni**, përfaqësues i fshatit Bellopojë, theksoi, kam disa kërkesa për investime në fshatin Bellopojë:



-Një lagje afër burgut të Nezirovite në fshatin Bellopojë është pa ujë, dhe është shumë e nevojshme tu sigurohet uji;

-Rregullimin e disa rrugëve në lagjet Rudari dhe Matarovëve në gjatësi prej 500 m;

-Shkolla është në gjendje të rëndë, nuk ka ngrohje qendrore, fusha e sportit ende nuk është ndërtuar;

- Një urë është ndërtuar para 7-8 vjetësh në lumin e fshatit, por është shembur, e ka dëmtuar uji dhe banorët duhet të sillen përreth 15 km për të hyrë në ara të tyre;

-Po ashtu rruga ne drejtim të shkollës duhet rregulluar sepse nxënësit po kanë shumë vështirësi gjatë shkuarjes në shkollë. Rrugën e fshatit e kanë shkatërruar automjetet e rënda gjatë punës në ndërtimin e burgut. Po ashtu ka nevojë për rregullimin e rrjetit të kanalizimit fekal;

- Kanalizimi burgut të sigurisë së lartë del në lumë;

- Ndriçimin publik për disa lagje të fshatit;

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** ne kemi një vit e gjysmë të qeverisjen tonë, urën që e përmende e dini si e kanë ndërtuar, pra nuk është ndërtuar si duhet. Ne vitin e kaluar e kemi rregulluar atë rrugë dhe kemi marrë shumë falënderime prej qytetarëve atje, për arsye se ajo rrugë dhe ura është duke u përdorur, ura ndoshta nuk është për automjete të rënda, por për mjetet që përdoren për bujqësi mund t'i përballojë dhe është funksionale. Sa i përket shkollës ne veç jemi në investime, për fusha sportive veç se tregova, operatori ka dal jo i përgjegjshëm dhe i'a kemi shkëputur kontratën, tani jemi në proces të kontratës së re dhe besoj se operatori i ri që do të përzgjidhet do t'i kryej këto punë sepse edhe fshatrat Siboc, Surkish, Pollatë, janë në të njëjtën situatë. Pra ne e kemi shkëputur kontratën dhe kemi kërkuar që operatori i papërgjegjshëm të futet në listën e zezë. Ju i dëgjuat projektet të cilat do të realizohen këtë vit, ishte edhe fshati Bellopojë dhe besoj që ajo rrugë do të rregullohet. Unë shpresoj shumë që edhe rruga e fshatit Dyz do të ndihmohet nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës, sepse e kam paraqitur si problem. Ju e dini që ato gropat e mëdha të cilat i kemi hasur tashmë nuk janë, e kemi bërë të kalueshme, jo ndoshta me standarde normale, por ne do të japim shtresën tjetër dhe do ta rregullojmë. Sa i përket kanalizimeve ne tash jemi në fazën e përzgjedhjes së një operatori i cili do të merret me këtë çështje dhe kisha kërkuar që problemet me kanalizime ti orientoni në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në formë të kërkesës dhe besojë se ai problem do të zgjidhet. Një numër i madh i problemeve sa i përket kanalizimeve janë zgjidhur, por sigurisht nuk janë kryer të gjitha, sepse ka nevojë për intervenime të reja por po bëhen intervenime edhe në ato që janë kryer më herët, për arsye se një pjesë e madhe e tyre janë punuar siç thotë populli shkel e shko dhe domosdoshmërisht duhet kthyer edhe njëherë në ato punë, por po shpresoj që sipas prioriteteve do i vëmë në dispozicion tërë kapacitetet tona për t'i zgjidhur këto kërkesa dhe nevoja të qytetarëve.

**z.Rexhep Dauti,** përfaqësues i fshatit Llaushë, theksoi, kemi problem me dy rrugë në fshat që janë lidhëse, fjala është për rrugën "Avdyl Dushkollli" përmes së cilës rrugë nxënësit shkojnë në shkollë, dhe rrugën "Rrahim Tashevc" e cila lidhë dy shkollat me rreth 600 m. Ka dhjetë vite që parashtrijë kërkesa për rregullimin e këtyre rrugëve. Në Llaushë u realizua një projekt, u rregullua një rrugë me zhavorr prej 850 m për një lagje "Imeri" ku është një projekt i shkëlqyeshëm, dhe po ashtu edhe pastrimi i lumit. Kemi nevojë edhe për disa kanalizime të shkurtra, ndërsa me ndriçim e kemi vetëm një lagje.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** çështjen e rrugës "Avdyl Dushkollli" e kemi diskutuar me Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe viti 2023 është vit kur do të rregullohen të dy ato rrugë dhe ajo pjesë do të lidhet. Nëse do të na krijohet mundësia, sepse jemi duke i përmbyll projektet në kuptim të tenderimit dhe me çfarë shumash po përmbyllen, nëse do të krijohet ndonjë buxhet shtesë dhe nëse mbesin mjetet nga tenderimet ka mundësi që edhe gjatë këtij viti të fillojmë me projektet, po qe se na lejon hapësira kohore. Sa i përket ndriçimit publik besoj se kemi edhe një varg rrugësh tjera që kanë nevojë për ndriçim publik. Bukur shumë është bërë në këtë aspekt, por sigurisht nevojat janë



më të mëdha, por besoj se edhe çështja e ndriçimit publik do të zgjidhet me kohë. Në Llaushë ju e dini se janë duke u realizua disa projekte, rruga që i lidh dy rrugët kryesore, të varrezat, rruga që e përmendët, pastaj pastrimi i shtratit të lumit, pra janë edhe një varg projektesh që janë duke u realizuar atje, por edhe këto që u theksuan besoj se do të realizohen së shpejti.

**z.Fadil Gërguri**, fshati Siboc i Poshtëm, theksoi, ka katër vite që ka ngelur lumi i pa pastruar, projekti ka ardhur deri në fshatin Siboc dhe kjo po paraqet pengesë të madhe. Ju Kryetar keni qenë dhe keni parë vërshimet që kanë ndodhur në fshat. Kanë shumë probleme banorët e fshatit. Fshati Siboc nuk u përmend fare në projektet që i keni premtuar për këtë vit, pyetja është se deri ku kanë shkua ato projekte dhe a do të bëhen, fjala është për rrugën në fshatin Kaqybeg. Ndriçimi publik ka ardhur deri në Siboc dhe aty është ndërprerë, trotuaret kanë ardhur deri në Siboc të poshtëm dhe aty janë ndërprerë, pastaj rrugët lokale.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, nga ajo që theksoi parafolësi rezulton që në fshatin Siboc nuk është bërë asgjë, por na e dimë që në Siboc është punuar bukur shumë dhe sigurisht që nuk janë kryer të gjitha punët se ka nevojë ende. Ne veç se e kemi tenderin me pastrim të lumit dhe besoj se Drejtoria përkatëse do të merret me këtë çështje. Nuk jemi duke u ngutur për faktin sepse ju e di si është vepruar më herët, është pastruar shtrati i lumit komplet dhe është hequr e tërë biomasa dhe kjo ka reflektuar në shkatërrimin e tokave bujqësore. Ne duke pastruar lumin duhet intervenuar me gabiona, për të siguruar që banorëve mos tu shkatërrohet toka bujqësore. Ju e dini që kemi familje që u janë shkatërruar me hektarë tokat si rezultat i këtyre veprimeve të papërgjegjshme që kanë bërë më herët, prandaj duhet shkuar që duke pastruar shtratin e lumit duke vepruar menjëherë me vendosë siguri që mos të shkatërrohet toka bujqësore, andaj ne do të punojmë në këtë kohë në atë pjesë, do të bëjmë një pastrim në mënyrë që t'u ikim atyre vërshimeve. Siboci besoj se ka një varg projektesh infrastrukturore që janë duke u realizuar këtë vit, që kanë filluar ose pritet të fillojnë një varg rrugësh, qoftë me zhavorr apo asfalt, ku do të përmbyllen gjatë kësaj periudhe kohore, por informatat më të sakta mund t'i merrni në Drejtoritë përkatëse. Siboci nuk është lënë pas dore asnjëherë, as tash nuk është duke u lënë pas dore sepse janë duke u realizuar dhe kanë me u realizuar një varg projektesh.

**z.Fadil Berisha**, përfaqësues i fshatit Kunushec, theksoi, problem nr.1 kemi ujësjellësin e fshatit, e që ky problem na përcjell ka 12-13 vite. Shpresojmë të bëhet një zgjidhje, gypi i ujësjellësit është deri te rruga magjistrale, përndryshe është punuar në disa projekte në fshat, asfaltim, trotuare, ndriçim. Kërkesa është për shtruarjen e një rruge në zhavorr prej pjesës qendrore të fshatit për t'u lidhur me lagjen "Deda", kjo rrugë shfrytëzohet për nevoja të bujqësisë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, sigurisht që i kemi parasysh këto që i përmendi parafolësi. Për problemin e furnizimit me ujë, janë probleme jo që ne i kemi shkaktuar. Ju e dini se infrastruktura e ujësjellësit kryesisht është punuar infrastrukturë private në vitet e mëhershme dhe gypi i vendosur nuk ka qenë kualitativ dhe të njëjtin problem e ka fshati Bellopojë. Në momentin që lëshohet shtypja për të arritur në lokalitete më lartë atëherë shpërthen gypi poshtë. Në fshatin Bellopojë ka dhjetëra vende ku humb uji i pijes për shkak të gypit dhe ju e dini se çështja e ujësjellësit është kompetencë ekskluzivisht e KUR Prishtina. Ne po financojmë infrastrukturë të ujësjellësit por me këto probleme ekskluzivisht duhet marrë kompania përkatëse e cila ka për obligim edhe investimet, për arsye se qytetarët paguajnë për atë kompani, për ato shërbime, por sidoqoftë ju jeni qytetarë tanë dhe ne jemi në dispozicionin tuaj. Pra të njëjtin problem kanë fshatrat Konushec, Buricë, Godishnjak që në periudha të verës ka problem të arrij uji deri në pikat e larta, për shkak se shtypja nuk guxon të lëshohet deri në maksimum si rezultat i kualitetit të dobët të gypit, prandaj ky problem duhet me u zgjedhë, në bashkëpunim me Ujësjellësin Rajonal Prishtina, por edhe ne si autoritet publik jemi të gatshëm të futemi në këto projeksione, në mënyrë që të zgjedhim problemin e këtyre lokaliteteve me ujë të pijes.



**z.Zeqir Retkoceri**, fshati Halabak, theksoi kemi një rrugë prej 2.2 km pa asfalt. Kemi bërë shumë kërkesa edhe më herët për rregullimin e kësaj rruge, por ende nuk ka asgjë. Kam një lutje që këtë vit të shtrohet në zhavorr, janë krijuar gropa tmerruese. Ka familje komplet që janë të sëmurë në atë rrugë, fëmijë me lëvizje të kufizuara.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, në kuadër të planifikimit, këtë vit nuk është paraparë ajo rrugë, mirëpo duhet të bëjmë përpjekje me DSHPMSh së paku për të zgjedhur problemin për këtë vit. Mbetet detyrë e DSHPMSh që të merret me këtë çështje.

**z.Raif Osmani**, fshati Dumnicë e Epërme, theksoi, është kërkesë e lagjes "Jaholli" për rregullimin e rrugës që lidh lagjen me pjesën e fshatit Dumnicë e Epërme, deri te shkolla e fshatit. Aktualisht rruga është e pakalueshme. Kërkesë tjetër është për largimin e një deponie ilegale, ku janë duke hedhur mbeturina në masë të madhe. A ka mundësi për vendosjen e ndonjë table për ndalimin e hedhjes së mbeturinave. Po ashtu kërkesa është edhe për transportin publik, ndonjë kombi të udhëtarëve. Një vërejtje kemi, kompania Bini ka filluar të marrë material (dhe) nga pjesa jonë, i cili ka bërë një gropë të madhe dhe policia ka qenë në vend të ngjarjes për të hetuar rastin dhe në këtë rast punëtorët kanë deklaruar se për këtë Komuna u ka lëshuar leje. Ata për shkak të ngarkesave të rënda kanë dëmtuar rrugën, dhe tani nuk jemi në dijeni se a duhet të dal Inspeksioni në vend të ngjarjes.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, nga kjo që u theksua, shohim se realizimi i një kërkesë nxjerr kërkesën tjetër. Fatmirësisht kërkesa rezulton për lidhjen e fshatit sepse rruga deri në fshat është asfaltuar, kështu që besoj se edhe atyre rrugëve do u vijë radha për rregullim, por sa i përket transportit, duhet të adresoheni në DSHPMSh, sepse ju e dini se operatorët që funksionojnë janë privat dhe ata e shohin edhe interesin e vet se a kanë mundësi të mbulohen me shpenzime me kryerjen këtij shërbimi në atë pjesë. Ne jemi në dijeni me këtë problem dhe Drejtoria përkatëse është marrë me këtë çështje, megjithatë është vështirë për t'i detyruar kompanitë private për kryerjen e shërbimit të transportit në linjat ku është vështirë për mbulimin e shpenzimeve. Sa i përket tërheqjes së atij materiali besoj se Drejtoritë përkatëse nuk kanë informacion lidhur me këtë çështje, andaj do të ishte mirë t'u drejtoheni Drejtorisë së Inspeksionit, e cila do të merret me këtë çështje dhe do ta trajtojë si problem. Në asnjë formë nuk lejohet dëmtimi i infrastrukturës rrugore në të cilën kemi investuar, si rezultat i keqpërdorimeve të tilla dhe besoj se me këtë çështje do të merremi seriozisht si institucione. Besoj se edhe këto rrugët lidhëse mes fshatrave do të përmbillen si projekte, por detyrimisht ne jemi të obliguar që investimet tona të orientojmë në rrugët që drejtpërdrejt lidhen me vendbanimin dhe me qytetarët. Në momentin që i përmbylim këto, pastaj ne sigurisht që do t'i rregullojmë edhe rrugët lidhëse mes lagjeve të ndryshme, të cilat në këtë aspekt mund të llogariten më sekondare në aspekt me ato primare që janë të lidhura drejtpërsëdrejt me lagjen.

**z.Raif Osmani**, fshati Dumnicë e Epërme, rruga ka qenë malore dhe është hapur, por për shkak të dëmtimit nuk ka mundësi të vijë kombi për të transportuar fëmijët deri në shkollë të fshatit Dumnicë e Epërme si dhe në shkollë të fshatit Llaushë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, çështja e cekur nga parafolësi të adresohet në DSHPMSh, si kërkesë, e cila do të dal dhe do të merret me këtë çështje dhe besoj se do të bëjmë zgjidhje.

**z.Raif Osmani**, fshati Dumnicë e Epërme, ne kemi parashtruar kërkesë në DSHPMSh, mirëpo ende nuk kanë dalë për të parë gjendjen e rrugës.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, që tani Drejtoria i DSHPMSh do të evidentojë kërkesën e shtruar nga ana e juaj dhe me një ekip do të dal në teren për parë gjendjen e faktike lidhur me rrugën dhe do të merremi seriozisht me këtë çështje.

**z.Bejtush Dushi**, dy kërkesa në takimin e fundit me qytetarë që i kam adresuar, ju falënderoj se njëra është realizuar, ndërsa njëra jo që ka të bëjë me shkollën ashtu si e kenë premtuar. Përgëzoj për fillimin e punimeve në rrugën "Skënderbeu", megjithatë nuk kisha pas dëshirë që kjo rrugë të përjetojë traumat e rrugës "Zahir Pajaziti", ku shiriti ku parashihet qarkullimi i veturave është i zënë nga automjetet e parkuar, ndërsa unë duhet të kaloj në shiritin tjetër që



vije nga ana e kundërt dhe kështu po rrezikohemi. Projekti për biçikleta më pëlqen por shtrohet pyetja kah duhet shkojnë ata. Pra shqetësimin e kemi se do të jetë ngjashëm sikurse me rr.”Zahir Pajaziti”. Kam një kërkesë për shërbime publike, për shkak se unë gravitojë shumë rrugën nga restoranti “ Artela “ deri te rruga e fshatit Obranqë, por jo vetëm unë por ajo pjesë u bë si shëtitore, pra kërkesa është që të mirëmbahet ndriçimi publik si dhe rregullohet edhe ajo pjesa e mbetur me trotuar, sepse po rrezikohen këmbësorët për shkak të vozitjes së shpejtë të automjeteve, sidomos nga bashkatdhetarët që janë duke vozitur shpejtë. Gjithashtu në atë pjesë ka nevojë të largohen edhe therrat dhe degët e drunjtëve që kanë zënë rrugën. Mbeturina mund të them se ka më pak, por problemi me qentë endacak është duke vazhduar dhe mendoj se është dashur t’u sigurohet ndonjë vend enkas për ta. Kam një kërkesë për Drejtorin e DBPZHR për subvencionimin e fermerëve që merren me pemishte, për shkak se këtë vit jashtëzakonisht shumë janë të sulmuara pemishtet nga insektet. Në fund ju falënderoj shumë për rrugën dhe premtimin e dhënë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, rruga “Skënderbeu“ do të rregullohet konform standardeve. Sa i përket shtegut të biçikletave unë pres që do kemi probleme, por njëkohësisht pres dhe kërkoj prej qytetarëve që të vetëdijesohen dhe të trajtojnë ashtu siç e meritojnë sepse edhe ajo është kategori e drejtpërdrejtë e pjesëmarrjes në komunikacion. Ne nuk e dëshirojmë sanksionimin e tyre, por të gjithë ata që shkelin procedurat e qarkullimit rrugor në atë stazë do të sanksionohen. Nuk do të ketë trase rruge ku do të komplikohet çfarë ka qenë hyrja dhe dalja në rr. “ Zahir Pajaziti”. Ajo rrugë do të jetë me dy shirita, njëra për hyrje dhe tjetra për dalje, shirita rrugor standard dhe nuk do të ketë komplikime, po ashtu edhe traseja për biçikleta do të jetë standarde sikur do të jetë edhe trotuari për këmbësorë. Prandaj unë pres probleme, por të gjithë ata që i shkelin rregullat sigurisht do të përballen edhe me sanksione përkatëse. Sa i përket ndërtimit të shkollës, këtë e kemi diskutua, mirëpo kemi pak probleme pronësore sepse në atë lokacion ku planifikojmë ndërtimin e shkollës nuk kemi hapësirë publike, domosdoshmërisht duhet mbështetur në hapësirat private, duhet gjetur mundësinë e shpronësimit të një prone private përmes procedurave të parapara. Në këtë aspekt është mirë të na ndihmoni edhe ju si qytetarë të asaj ane, në kontakt me qytetarët tjerë atje, sepse detyrimisht do të jemi të detyruar të blejmë një parcelë, përkundër faktit që është edhe një tjetër problem, fatkeqësisht është duke na rënë numri i nxënësve dhe afërsia mes shkollës “ Ibrahim Rugova “ dhe shkollës së fshatit Llapashticë e Poshtme dhe Llapashticës së Epërme nuk është shumë e madhe. Megjithatë ajo lagje ka nevojë të ketë shkollë, s’paku një objekt shkollorë prej klasës së parë deri të pestën dhe unë kam gatishmërinë për zgjedhjen e këtij problemi, por kisha kërkuar nga ju të nderuar qytetarë që ju të gjeni një mirëkuptim me personat që kanë parcela ku kishte me qenë e përshtatshme për ndërtimin e një objekti shkollorë, më pastaj në pajtueshmëri me ta unë jam i gatshëm t’i qasem dhe për të gjetur formën për financim të hapësirës. Si autoritet komunal ne marrim përsipër financimin e ndërtimit të objektit. Rruga të cilën e përmendët e cila është bukur shumë e frekuentuar, Drejtori i Shërbimeve publike ka informacione dhe do të merret me këtë çështje, si me mirëmbajtjen e ndriçimit publik, ashtu edhe me zgjerimin e asaj pjese me trotuar që mungon dhe do të rregullohen. Sa i përket bujqësisë Drejtori i DBPZHR është prezentë dhe do u jap sqarimet e nevojshme.

**z.Fatmir Rudari,** Drejtor i DBPZHR, theksoi, Bejtush pyetja e juaj ishte me vend, unë të pres në zyrë kurdo që ke për të diskutuar lidhur me të gjitha problemet që kanë të bëjnë me bujqësinë. Këtë vit nuk kemi të planifikuar projekte për atë që theksuat. Unë si Drejtor detyrën e kam pranuar më 24 janar të këtij viti dhe të gjitha projektet kanë qenë thujtë të iniciuara për këtë vit, por për vitin e ardhshëm çdo ide apo sugjerim i juaj është i mirëseardhur.

**Xhafer Gjata,** Podujevë, theksoi, ju uroj për punët e shumta të deritashme të kryera nga ana e Juaj. Kam një kërkesë që mundësisht të gjeni mënyrën që ta largoni nga rruga një person me të meta mendore. Fëmijët po kanë shumë probleme gjatë shkuarjes në shkollë, sepse ai



shtrihet në rrugë përballë lokale të mia dhe fëmijët po frikohen të shkojnë në shkollë, edhe pse ai faktikisht nuk është duke vepruar diçka por fëmijët po frikohen. Të shikohet mundësia të bëhet ndonjë zgjidhje lidhur me të. Problem tjetër kemi me automjetet në përgjithësi, në veçanti taksitë ilegale ku po parkohen dhe na bllokojnë rrugën për të hyrë në shtëpi. Dikush nga parafolësit përmendi mbeturinat, dua të theksoj se në qytet nuk ka më mbeturina, qyteti asnjëherë më i pastër nuk ka qenë. Edhe një kërkesë kam, të rinjtë dalin dhe hedhin fara, mendoj se do të duhej angazhuar pak më tepër punëtorët.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** ju e dini që ne kemi pas dy persona që vuajnë nga çrregullimet psikike dhe fatmirësisht kemi arrit me zgjedhë problemin e tyre sepse sjellja e tyre u bë problematike për qytetarët dhe në mirëkuptim me Qendrën e Shëndetit Mental tashmë ata janë në rehabilitim dhe besoj se është bërë një punë e mirë me ta dhe kjo ka ndodhë pas 22 vitesh në Komunën e Podujevës. Të njëjtën gjë kemi filluar procedurën për personin e cekur nga parafolësi dhe jemi në pritje të përgjigjes. Unë si institucion kam gatishmërinë të marr përsipër të gjitha shpenzimet për këta persona, vetëm e vetëm ti largojmë nga rruga dhe t' i trajtojmë ashtu çfarë e meritojnë, sepse edhe ata janë pjesë e jona dhe ndihemi keq për gjendjen e tyre, por kemi për obligim t' i trajtojmë dhe t' u krijojmë kushte të mirëfillta. Çështja e taksive ilegale është një shqetësim jo vetëm për lagjen e juaj, kemi shqetësim edhe për pjesën e lokali "Pranvera". Ju jeni në dijeni se nuk është se nuk kemi marrë veprime, madje kemi marrë veprime edhe me patrulla statike të policisë, dhe në momentin që largohemi, pas pesë ditash prapë kemi të njëjtën gjendje. Ju kemi ofruar zgjidhje, kemi kërkuar nga ata të gjejnë një lokacion të përshtatshëm, ndërsa për ata poshtë u kemi ofruar lokacionin prapa stadiumit, mirëpo kjo situatë është bërë bukur problematike sepse janë shkelës rezidentë dhe përsëritës të këtyre veprimeve, por të jeni të bindur se policia duhet pak më tepër të angazhohet, ka nevojë për një angazhim shtesë. E dimë që edhe përkundër faktit se Stacioni i Policisë ka kaluar në nivelin e parë deri më sot ende nuk është plotësuar me resurse humane, kanë nevojë dhe kanë mungesë të resurseve humane. Ne jemi në kontakt të rregullt çdo ditë me policinë dhe po kërkojmë shërbime më të shumta, por arsyeja është se ka mungesë të stafit. Besoj se në të ardhmen këto shërbime kanë me u përmirësua dhe shpresoj shumë që edhe çështja e taksive ilegale do të zgjidhet. Sa i përket pastërtisë, i kemi kushtuar vëmendje të madhe, por mbetet ende për tu bërë. Megjithatë nga qytetarët do kërkoja të jenë më të kujdesshëm, pa ndihmën e tyre nuk bëhet asgjë. Nëse një qytetar del dhe han fara në shesh dhe i hedh në tokë është papërgjegjësi qytetare, andaj nga këtu kërkoj edhe nga qytetarët që nëse neve po na shohin çdo ditë duke bërë përpjekje me qëllim të ngritjes së këtyre shërbimeve, atëherë të na ndihmojnë, sepse pa ndihmën e tyre nuk mund ti bëjmë këto dhe një ndihmesë e vogël e tyre është një ndihmesë e madhe për ne për t' i kryer më mirë këto punë.

**z.Xhafer Imeri,** fshati Metehi, theksoi, kam një kërkesë, fjala është për rregullimin e një rruge me zhavorr, rruga edhe ashtu është bërë thuajse pakalueshme, nga balta therrat që e kanë bllokuar sepse pronarët e tokave pran nuk po lejojnë prerjen e therrave, e kjo fillon prej lagjes së Zukovite dhe vazhdon dhe lidhet me fshatin kërpih.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** për këto që theksove, drejtohuni te Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, të cilat do të veprojnë dhe do të trajtojnë këtë çështje dhe besoj se do të zgjidhet ky problem.

**z.Zymer Kadriu,** Dumnicë e Epërme, theksoi në fshatin tonë ka filluar rregullimi i parkingut te varrezat por nuk është përfunduar, pastaj filloi rregullimi i rrugës nga lagja e Kaqanollëve deri te Rudarët edhe ajo nuk është përfunduar, kanë mbetur 500 m pa u rregullua. Banorët e lagjes së Rudarëve nuk kanë mundësi të dalin dhe të lidhen me fshatin Llaushë. Edhe te varrezat e mia më keni premtuar se do i bëni rrethojë, por atë e kam bërë vet. Vetëm desha të them se nëse ju si autoritet publik nuk e përfundoni punën e parkingut te varrezat unë do ta bëj personalisht me mjete të mia.



**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** projektet e cekura nga parafolësi besoj se do të kryhen, mirëpo realizimi i tyre bëhet sipas prioriteteve, megjithatë çështja të varrezat dhe për rrugicat e cekura do të zgjidhet. Të jeni të bindur se kemi një numër të madh të projekteve që ndoshta janë shumë më me prioritet se sa kjo për të cilën ju po diskutoni, pa qëllim të anashkalimit të atij projekti sepse është rëndësia e atyre projekteve.

**z.Agron Hyseni,** banor i lagjes së Dëshmorëve, theksoi, kërkesa është për rregullimin e disa rrugëve që kanë mbetur pa u asfaltuar dhe kemi nevojë për ndriçim publik në lagje. Kërkesë tjetër është rruga në drejtim të lagjes që lidhet me magjistrales Podujevë-Prishtinë është pa pengesa, andaj ka nevojë për vendosjen e disa pengesave për shkak të rrezikut nga vozitja e shpejtë e automjeteve, sidomos do theksoja rrezikun për fëmijët gjatë shkuarjes në shkollë. Kërkesë tjetër është për rregullimin e shportave për mbeturina në pjesën të pishat si dhe rregullimin e një pjese të ndriçimit publik në atë pjesë i cili është jashtë funksionimit. Pastaj edhe në këtë pjesën e sheshit ku po kalojnë veturat jemi në rrezik gjatë kalimit.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** parafolësi ngriti disa tema, e para Lagja e Dëshmorëve në masën më të madhe është e mbuluar me infrastrukturë. Janë disa rrugica të vogla të cilat besoj se do u vijë radha dhe do zgjidhen ato probleme. Sa i përket pengesave, tash po shohim se këto pengesa kanë filluar të bëhen pengesë në rrugë. Ne nuk jemi të mos ketë pengesa, por jo në formën alarmante sa janë kërkesat, sepse në njërin anë po kemi kërkesa për asfaltim, në anën tjetër ende pa e asfaltuar po kërkojnë pengesat, kështu që ose po i asfaltojmë, ose po i lëmë ashtu siç janë në zhavorr. Pengesat duhet vendosur vetëm në ato pikat që janë shumë të rrezikshme, prandaj ne e vlerësojmë ku janë pikat më kritike dhe vet do i vendosim, por nuk do të ketë pengesa pa kontrole qysh kanë vepruar deri tash. Sa i përket parkut të paqes të Mançesterit, tashmë jemi në fazën finale, besoj shumë shpejtë këtyre ditëve do të nënshkruhet kontrata, ku parku do të pastrohet komplet nga therrat, shkurret etj, dhe do t'i jepet një pamje çfarë e meriton të ketë një park i qytetit dhe do ta ketë komplet infrastrukturën përcjellëse. Duke nisur nga Zyra ime, Nënkryetarja dhe Drejtorët e Drejtorive përherë do të jemi në dispozicionin tuaj, çdo kërkesë dhe nevojë mund ta adresoni në çfarëdo kohe.

**z.Kreshnik Hyseni,** theksoi, kam problemin me një kanalizim, sa herë që ka reshje të mëdha të shiut, uji nga kanalizimi derdhet në pusin e shtëpisë. Për këtë ka qenë i informuar edhe Drejtori i DSHPMSh dhe ka qenë në vend të ngjarjes. Është shumë e nevojshme që tani për ta pastruar, jemi në gjendje të rëndë sa i përket kësaj.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** me kanalizime kemi probleme bukur të mëdha. Në disa vende që është punuar më herët, është punuar gjoja për t'i sanuar këto, me i rregullua, por përkundrazi si rezultat i "ekspertizës së fortë" që e kanë pas na kanë shkaktua telashe edhe më të mëdha se sa që kanë qenë. Në grupin e atyre problemeve që janë shkaktua është edhe problemi që theksoi parafolësi dhe problemi të Kutleshtë aty poshtë, ku shihet në çdo reshje kemi vërshim të asaj sipërfaqeje. Drejtoria përkatëse është duke u marrë me këtë çështje dhe besoj së shpejti do të bëhet një zgjidhje për atë pjesë të qytetit të Podujevës.

Nëse nuk ka tjerë të interesuar të marrin fjalën, e përmbyllim takimin duke ju falënderuar shumë për kontributin e dhënë në këtë debat publik, për pyetjet dhe sugjerimet e dhëna, si dhe për vërejtjet e paraqitura. Do të bëjmë përpjekje maksimalisht që bashkërisht me Ekzekutivin të jemi në dispozicion të kryerjes së tërë këtyre punëve dhe projekteve të cilat janë me interes tuajin. Dera jonë është e hapur gjithmonë për qytetarët e Komunës sonë, jemi në dispozicion dhe në shërbim të juajin. Duhet të keni nganjëherë durim sepse jo të gjitha mund të kryhen brenda një periudhe të shkurtër kohore. Keni mirëkuptimin, jemi një vit e gjysmë që kemi marrë qeverisjen lokale. Po bëjmë të pamundurën që gradualisht të zgjidhim këto punë dhe probleme të juaja. Faleminderit shumë.







Mbledhja përfundoi në orën 12.25

Procesverbalin e mbajti  
Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0051420/22  
Podujevë, 27.06.2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





